



Departamenti i Prokurimit

Prishtine : datë, 30.06.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 27.06.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “OFFICE 1 Kosova”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me libra për bibliotekat shkollore”, me Nr. të Prok: 616 20 2793 121 nxjerr:

V E N D I M

1. **Aprovohet pjesërisht** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik të “OFFICE 1 KOSOVA” të dt. 27.06.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me libra për bibliotekat e shkollave me numër 616 20 2793 121 kundër Njoftimit për Kontratës të AK –së, të datës 12.06.2020 të publikuar në web-faqe të KRPP-së .
2. **Ndryshohen kërkesat e FDT-se duke u bazuar në Vendimin e OSHP-se për një procedurë tjetër për furnizim me libra në baze të ankesave të po të njëjtit pretendues ;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit duke ndryshuar kërkesat, duke i harmonizuar me rekomandimet e OSHP-se dhe duke vazhduar afatin e dorezimit të tenderit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m


Operatori Ekonomik Swismed me datë 27.06.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Furnizim me libra për bibliotekat e shkollave**” me numër të Prok: Nr 616 20 2793 121. Autoriteti Kontraktues, me datë 29.06.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretenduesi si zakonisht ka shume pretendime te pa bazuara dhe te pa argumentuara sepse edhe ai e din si cdo OE-ik qe merret me kete lemi se duhet ne cdo rrethane te respektohet e drejta e autorit dhe e njejta te mos keqperdoret dhe se e vetmja mundesi per te rujatur kete eshte qe librat te merren nga shtepite botuese qe i kane keto te drejta.

Por duke u bazuar ne faktin se kete nuk e ka marre parsysh Paneli Shqyrtues i OSHP-se dhe se ka rekomanduar qe kerkesa per marreveshje me shtepite botuese te mos vendoset ne dosjen e tenderit pasi qe sipas tyre paraqet kufiizim te konkurrence,edhe ne kete aktivitet kriteri i kontestuar do te hiqet.

Zyrtarja e prokurimit do te ndermarr menjehere veprimet per ndyshim te kerkeses se kontestuar dhe vazhdimin e afatit per dorezim te tendereve.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES

Për Aktivitetin e Prokurimit: Furnizimi me libra i bibliotekave shkollore

Sa i përket tenderit për

Nr1 i prokurimit	616-20-2793-1-2-1
Nr i brendshëm	616 20 84 121

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

"OFFICE 1 KOSOVA"

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga Tirana, p.n

(Adresa)

Prizren

(Vendi)

/

(Numri Telefonit)

20.000

(Kodi postar)

/

(Numri i Faks-it)

Hasan Gigollaj- Drejtor

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

office1kosova@hotmail.com

(Adresa elektronike)

27.06.2020.

(Data e parashtrimit të kërkesës)


(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtoj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

/_____
(Emri i avokatit)

/_____
(Adresa e plotë)

/_____
(Numri i Telefonit)

/_____
(Numri i faks-it)

/_____
(Adresa elektronike)

/_____
(Data e parashtrimit të kërkesës)

/_____
(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”; nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi per kontrate 12.06.2020.
Njoftimi per dhenie te kontrates /
Afati i fundit per dorzimin e ofertav 02.07.2020.
Data dhe ora e fillimit te hapjes se ofertav 02.07. ora 14:00
Kriter per dhenie te kontrates: Tenderi i pergjegjshem me cmim me te ulet
Të gjitha njoftimet janë publikuar në platformën e-prokurimi.rks-gov.net

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

NA

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

NA

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1- Qellimi
Neni 6- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 52- Njoftimi i kriterëve për dhënie të kontratës
Neni 69- Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

AK/KK Prishtine ne inicimin e aktivitetit te prokurimit ne fjale ka bere shkelje ligjore pasiqe ka vendos kritere diskriminuese ne dosjen e tenderit dhe ka minimizuar konkurencen per kete projekt.

Kriteri nr.2 lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional te pershkruar ne nenin 9.1&9.2 te FDT-se si ne vijim:

2. OE-ik duhet te kete marreveshjen me shtepite botuese per furnizim me libra per kete projekt.

2. OE-ik duhet te ofroj deshmi - Kopjet e marrveshjeve per kete projekt me shtepite botuese per furnizim me libra sipas emrave dhe titujve te paraqitur ne Aneksin 1

Eshte kriter diskriminues dhe minimizon konkurencen perkatesisht i eshte pershtatur nje OE te caktuar ne kete menyre AK formen si ka inicuar aktivitetin e prokurimit rezikon te diskrimohen te gjitha OE tjere te interesuar per pjesmarrje dhe keqperdorimi i buxhetit pasiqe oferta e vetme e pergjegjshem sigurisht do te ofroje cmime manipulative (jo normalisht te larta).

Pas shkarkimit te dosjes se tenderit dhe pergaditjes, ne momentin qe kemi filluar kontaktet me shtepite botuese te cilat na kane njoftuar se mareveshja per kete projekt eshte bere me librarine Artini- Prishtine ende pa u publikuar tenderi nga KK Prishtine ne konstatojme se ky projekt i eshte pershtatur nga autoriteti kontraktues nje OE te caktuar i cili edhe ne vitet paraprake eshte shperblyer me kontrate nga AK.

Monopolizimi dhe mundësia për ta fituar këto kontrata OE në fjalë është dhënë nga AK-KK Prishtinë me futjen e kriterit të lartëcurës pasiqe në këto lista ka përfshirje dhe të shtepisë botuese toena nga Shqipëria ekskluzivitetin e të cilave për Kosovë e ke libraria Artini dhe është e pamundur të merret autorizimi nga shtepia botuese për këta tituj. AK kur ka vendosur përpilimin e një kriteri të tillë poashtu ka shkelur nenin 69 të LPP-se pasiqe në asnjë prej pikave të këtij neni nuk lejohet/parashihet një kriter i tillë, citoj nenin 69 të LPP-se:

2. Gjatë udhëheqjes së procedurave që shpëien drejt dhënies së kontratës publike në të cilën përfshihet livrimin i produkteve, nga operatorët ekonomik mund të kërkohet që të dëshmojnë aftësinë e tyre teknike përmes një ose më shumë mjeteve në vijim, sipas llojit, sasisë dhe qëllimit të produkteve që duhet të furnizohen:

2.1. listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar produktet e furnizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkënenëshkuara nga autoriteti i tillë; (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë;

2.2. përshkrimin të pajisjeve teknike të operatorit ekonomik, masave të sigurimit të cilësisë dhe pajisjeve për zhvillim;

2.3. shënimin për përfshirjen e teknikëve dhe organeve teknike, sidomos të atyre që janë përgjegjës për kontrollimin e cilësisë;

2.4. mostrave të produktit, përshkrimeve, prezantimeve grafike dhe/ose fotografive të produkteve që duhet të furnizohen; dhe/ose

AK me rastin e përpilimit të dosjes së tenderit ka cektuar kërkesa të cilat do të ndikojnë në reduktimin apo eliminimin e konkurrencës me kundërshtim me nenin 7 të LPP-se. Po ashtu kërkesa e AK-se se OE duhet të kenë marrëveshje me shtepite botuese dhe mos pranimi i shtepive botuese që të lidhin marrëveshje me OE tjere përveq OE në fjalë, do të ndikojë në pamundësinë e ofertimit të OE tjere në këto mënyra shkelet neni 1 i LPP-se sepse kjo kërkesë do të ndikonte në mos arrijtjen e qëllimit për këto aktivitete të prokurimit dhe çmimi i ofruar do të jetë në dorë të një OE të caktuar në këto mënyra nuk mund të sigurohet mënyra me efikasë dhe transparente e shfrytëzimit të fondeve publike.

Kërkesën për ri-shqyrtojme e bazojme dhe në vendimin e organit me të lartë shtetëror për mbikqyrje të prokurimit publik, shih vendimin e OSHP-se 321/20 të dt. 26.06.2020.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Si pasojë e shkeljeve të lartëcekura nga AK përpilimi i dosjes është bërë jo në harmoni me ligjin për prokurim publik dhe udhëzimin operativ për prokurim publik, AK ka vendosur kriteret jo të matshme të cilat minimizojnë konkurrencën dhe zhvillimi i procedurës në këto forme AK do të maksimizojë koston e projektit pasiqe OE në fjalë duke qenë në dijeni se nuk ka konkurrencë do të fryjë çmimet siq ka vepruar dhe në të kaluarën.

Kërkojmë nga zyrtari kryesor i prokurimit të bëjë ndryshimet në dosjen e tenderit, të largojë kriterin nr.2 lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional dhe të zgjatet afati për dorëzim të ofertave në të kundërtën lenden do të dergojmë në OSHP.

Kërkojmë që ankesa/kërkesa për ri-shqyrtim të aprovohet si e bazuar.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*